



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Komuna e Drenasit



|         |                   |
|---------|-------------------|
| Shkresë | 24.11.2025        |
| Nga:    | ZPP Gentiana Qela |
| PER:    | N.T. „Fer-Petroll |
| Lenda : | VENDIM            |

Në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 10, nën paragrafi 10.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068 si dhe Ligjin 04/L-237 si dhe Ligjin nr. 05/L-092 si dhe Rregullores (A01) nr. 002/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “N.T. „Fer-Petroll...të datës 21.11.2025 kundër njoftimit per kontrate për procedure të prokurimit me numër 611-25-5498-5-1-11 me titull “REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDERTIMI I TROTUARIT ARLLAT-NEGROVC DHE VUQAK” dates 18.06.2025, Komuna e Drenasit (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit sjell:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik N.T. „Fer-Petroll “të datës 21.11.2025 kundër njoftimit per dhenje të aktivitetit të prokurimit me numër 611-25-5498-5-1-1 me titull “REHABILITIMI I RRUGËS DHE NDERTIMI I TROTUARIT ARLLAT-NEGROVC DHE VUQAK” datës 18.06.2025
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin per dhenje të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “N.T. „Fer-Petroll...si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues ka analizuar pretendimet e juaja ankimore dhe ka vlersuar se pretendimet e paraqitura jane te pabazuar pasi qe siq edhe keni vrejt ne qajen ne dokumenta jane te bashkangjitura tre vertetimi i gjykates per OE e rekomanduar per kontrate eshte ne rregull pasi qe eshte jo me i vjeter se 6 muaj sipas dates se njoftimit per kontrate siq edhe e shihni ne qasje e njeta vlen edhe per vertetimin e ATK

Ndersa sa i perket pretendime te tjera te gjitha jane te paqendrueshme :

Sa i perket Inxhinerit te infrastruktures rrugore kerkesa ka qene se paku 6 vite pune profesionale e cila kerkese eshte plotesuar nga ana e OE .

Ndersa sa i perket inxhinerit per komunikacion – Eshte plotesuar kerkesa pasi qe ka diplomuar ne vitin 2019 ne qershor . 2019-2025 ( 6 vite ) .

Minimum i person te certifikuar per menaxher i repartit punues i cili eshte trajnuar dhe certifikuar ne bazë te parimeve te ISO 18001 2007, inspektor zbatues i sistemit 18001 OHSAS per punëtoret ne vend punishte per te qene konform me kërkesat qe dalin nga aspekti i sigurisë ne punë.- Kjo kerkese eshte plotesuar nga ana e OE te rekomanduar per kontrate .

Lista e stafit mbështetës të angazhuar në projekt ; Një listë prej së paku minimum 10 puntorë

Minimum i person te certifikuar per manipulues te makinerive te rënda.

Minimum i person te certifikuar per kranist(vinç)- OE ka ofruar deshmit per keto kerkesa .

Ndersa sa I perket kerkese per “Kapital te mjaftueshem per realizimin e kontratës, mjete te gatshme ne llogari, mbështetje nga Banka ose akses ne kredi nga Banka ne vlerë

200,000.00€ (dyqindë mijë euro) euro” eshte ne dokumente por per arsyje se ka qene ne kerkese per secret afarist nuk eshte bashkangjitur ne qasje por mund te vini ta vertetoni ne Zyren e Prokurimit .

Ndersa sa i perket per pretendimet per OE Grup i Operatorëve Ekonomik N.T. „Fer-Petroll; MINERAL L.L.C njoftojme se mbetet ne fuqi B-42 dhe ju jeni eliminuar sipas vendimit te OSHP –se .

Kunder ketij vendimi keni te drejt ankese ne OSHP ne afatë prej 10 ditë !

Me respekt !